

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

PROJEKTIT: KUJDESI SHËNDETËSOR I QASSHËM DHE CILËSOR (NË TEKSTIN E MËTEJTMË "KSHQC")

përfaqësuar nga Dr. Qamile Ramadani

dhe

ODËS SË INFERMIERËVE TË KOSOVËS (OIK)

përfaqësuar nga z. Naser Rustemaj

Lënda:

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (MB) lidhet në mes të Projektit Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor (KSHQC) dhe Odës së Infermierëve të Kosovës. (OIK) bazuar në Marrëveshjen e Ministrisë së Shëndetësisë (Republika e Kosovës) dhe Departamenti Federal i Punëve të Jashtme (Agjensise Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim) e datës 29 prill 2016.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i përgjithshëm i marrëveshjes është akreditimi i aktiviteteve trajnuese të projektit “Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor” (KSHQC) “

Projekti “Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor” (KSHQC) në Kosovë financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe implementohet nga Konzorciumi Swiss TPH dhe Save the Children.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit KSHQC është që të sigurohet se shëndeti i popullsisë së Kosovës është përmirësuar, me ofrues dhe menaxher të kujdesit parësor shëndetësor (KPSH) të fuqizuar dhe të aftë të përmbushin nevojat e pacientëve (sidomos grupeve të cenueshme), të cilët janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe nevojat e tyre.

Projekti do të kontribuojë në tri Komponenta/Rezultatet e mëposhtme (objektivat specifike):

Rezultati 1: Ofruesit e Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) janë më mirë të trajnuar dhe pajisur si dhe ofrojnë shërbime cilësore në fushat prioritare klinike.

Rezultati 2: Menaxherët në nivel komunal dhe në nivel të klinikave janë fuqizuar dhe kryejnë funksionet e tyre të planifikimit, buxhetimit, menaxhimit dhe mbikëqyrjes mbështetëse në mënyrë më efektive dhe efikase.

Rezultati 3: Ndërgjegjësimi i popullsisë rreth shëndetit është rritur dhe ofruesit janë më të informuar për nevojat e pacientëve dhe i marrin ato parasysht përmes proceseve të përmirësuar të informatave kthyese (feedback)/ndërveprimet me autoritetet shëndetësore

Neni 2

Obligimet e Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK)

1. Fasilitimi i akreditimit të profesionistëve shëndetësor të trajnuar në të tri komponentet e projektit;

2. Të bëjë akreditimin e programeve të trajnimit sipas standardeve të Odës së Infermierëve (sipas rekomandimeve të OIK-ut);

3. Të mbështesë pjesëmarrjen e profesionistëve shëndetësor relevant në trajnime të organizuara nga të tri objektivat për t'u ngritur profesionalisht dhe në fushën e menaxhimit shëndetësor:

a) Përfshirja e profesionistëve shëndetësor (KPSH) gjatë kurseve të trajnimit për ofruesit e shërbimeve për të mbështetur zbatimin e paketës së shërbimit; Trajnimi i stafit për 'paketën e shërbimeve' Trajnimi i infermierëve në Këshillim Motivues' Trajnimi i infermierëve për edukimin shëndetësor **(Komponenta 1)**;

b) Trajnime të menaxhimit shëndetësor; Objektiv I përgjithshëm I këtij programi trajnues është të zhvillohen kapacitetet e menaxherëve shëndetësor për të performuar në mënyre më efikase e më efektive funksionet e tyre menaxheriale në kuadër të kujdesit primar shëndetësor dhe kështu të jenë në gjendje të drejtojnë ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore. Pjesëmarrës të programit trajnues do të jenë mjeket dhe infermieret e nivelit menaxherial ne KPSH. **(Komponenta 2)**

c) Trajnim për implementimin e standardeve për prodhimin e materialeve ESH/PSH, Trajnimi për OJQ-të mbi Zbatimin e Standarteve për Prodhimin e Materialeve ESH/PSH, Trajnim mbi Modelin për sjellje dhe ndryshime sociale për udhëheqësit e komunitetit / OJQ-të / OShC / OBK **(Komponenta 3)**

Neni 3

Obligimet e “Projekti “Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor” (KSHQC)

1. Përgjegjëse për menaxhimin/kontrollin/financimin e përgjithshëm të projektit dhe koordinimin me akterë të tjerë institucional pjesëmarrës në projekt;
2. Koordinon zbatimin e projektit të përgjithshëm sipas Kornizës Logjike dhe dokumenteve tjera të planifikimit;
3. Harton Planin e Veprimit specifik për përfshirjen e insitucioneve shëndetësore vendore publike në projekt;
6. Organizon dhe monitoron në bashkëpunim me institucionet shëndetësore relevante te tri komponentet e projektit;
7. Përpilimi i udhëzuesit/fletushkave në bashkëpunim me institucionet shëndetësore relevante rreth projektit për qasjen në shërbime shëndetësore;

Neni 4

Realizimi i projektit

Kjo Marrevëshje do të jetë e vlefshme nga muaji Qershor 2019 deri në muajin Dhjetor 2019 me mundësi vazhdimi të projektit edhe për katër vite tjera deri në fund të vitit 2023. Ripërtirja e Marrëveshjes do të bëhet për (4) katër vitet e ardhshme ne Janar 2020. (Ripërtirja do të bazohet në rregullat e Odës së Infermerëve të Kosovës - OIK-ut).

Marrëveshja mund të ndryshohet /amandamentohet me pëlqimin e ndërsjellët të palëve. Të dy palët kanë të drejtë që të rinegociojnë marrëveshjen duke u bazuar në të drejtën e tyre të përcaktuar. Çdo modifikim i kësaj marrëveshje duhet bërë me nënshkrim të të dy palëve.

Neni 5

Kushtet e përgjithshme

Kjo Marrëveshje bashkëpunimit përmban 4 faqe dhe është përpiluar në 4 ekzemplarë të njëjtë, prej të cilëve nga 2 ekzemplarë i marrin palët kontraktuese.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi. Kontrata hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

PALËT

Projekti

“Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor”

”Oda e Infermierëve të Kosovës”

(OIK)

Dr. Qamile Ramadani



(Zv.Udheheqese e Ekipit)




Data: 30 .05. 2019

Dr. Naser Krustemaj

(Kryetar i OIK-së)

Data: 30.05.2019